

VENDIM
Nr.263, datë 6.4.2011

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.759, DATË 15.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E
KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË
STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR
2010-2011”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 dhe 5 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14 të vendimit nr.759, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet pika 14.1, me këtë përmbajtje:

“14.1. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para për bashkinë e Tiranës dhe bashkinë e Kuçovës, është data 15 prill 2011.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha